

RAPORT

"Në lidhje me procedurën e blerjes së energjisë elektrike për periudhën 01.10.2017-31.10.2017, me kredinë e Bankës Botërore"

Bazuar në pikën 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.483, datë 05.07.2017, "Mbi blerjen e energjisë elektrike nga KESH sh.a., ne zbatim të Marrëveshjes së Kredisë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim e Zhvillim, në përmbushje të detyrimit të shërbimit publik, në kushtet e një viti të pafavorshëm hidrik, dhe për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.244, datë 30.03.2016", pikën IV.II "Përshkrimi i metodave të prokurimit të Manualit të Operimit të Projektit (Projekti i Rimëkëmbjes së Energjisë/ID P144029, i miratuar më 26 Janar 2015) si dhe në zbatim të Urdhërit të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, "Mbi zhvillimin e procedurës së blerjes së energjisë elektrike për periudhën 01.10.2017- 31.10.2017", Komisioni i Vlerësimit të Ofertave zhvilloi procedurën e blerjes së energjisë elektrike, duke ftuar kompanitë tregtare dhe prodhuese të energjisë elektrike, të cilat plotësojnë kushtin e përcaktuar në nenin 10, të "Rregullave dhe procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a., nga tregtarët vendas dhe të huaj", miratuar me Vendimin nr.30, datë 23.03.2011, të Bordit të ERE, të paraqesin ofertat e tyre.

Në datën 27 Shtator 2017, në orën 09.00, ora lokale, ashtu sic ishte specifikuar në Kërkesën për Ofertë nr.4870, datë 25.09.2017, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave filloi procedurën e hapjes dhe leximit të ofertave. Nga 28 (njëzet e tetë) kompani të ftuara 11 (njëmbëdhjet) paraqitën oferta, konkretisht si më poshtë vijon:

- 1- GEN-I Tirana shpk
- 2- EFT AG
- 3- GSA sh.p.k
- 4- EZPADA doo Beograd
- 5- DEVOLL Hydropower sh.a.
- 6- AYEN Energy Trading sh.a.
- 7- NOA Energy Trade sh.p.k
- 8- A & A Group sh.p.k
- 9- HSE doo
- 10- Axpo doo Beograd
- 11- Network for Trading doo Beograd

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave renditi ofertat duke nisur nga cmimet/njësi më të ulëta dhe kapacitetet përkatëse deri në sasinë e kërkuar nga KESH sh.a. dhe i dërgoi Bankës Botërore Raportin e Vlerësimit të Ofertave për dhënien e miratimit/"no objection", sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Operimit.

Në datën 28 Shtator 2017, Banka Botërore dërgoi miratimin e saj/"no objection" në lidhje me Raportin e Vlerësimit të Ofertave të blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a.-ja për periudhën kohore 01-31 Tetor 2017. Por bazuar në permisimin e treguesve hidroenergjitike dhe me qëllim optimizimin e prodhimit të kaskades së Drinit për muajin Tetor 2017, KESH sh.a. vendosi të blejë vetëm 150 MW energji elektrike në band, konkretisht si më poshtë:

Kompania EFT AG:

Lot

Shitesi: EFT AG;
Bleresi: KESH SH.A.;
Periudha e levrimit: 01 – 31.10.2017;
Profili i levrimit: 00:00-24:00 (24 ore), (CET, Koha lokale e Shqipërisë) për gjithë periudhën;
Kapaciteti: 150 MW;

Sasia:	111,750 MWh;
Cmimi:	50.85 EUR/MWh;
Vlera totale:	5,682,487.50 Euro;
Pika e levrimit:	Kufiri Serbi/Mali i Zi/Greqi- Shqiperi;
CBC :	Siguruar nga EFT AG.

Bazuar në rezultatet e mësipërme, KESH sh.a. ka blerë 111,750 MWh sasi të energjisë elektrike ose kapacitetin 150 MW me një cmim/njësi mesatar prej 50.85 Euro/MWh.

Lëvrimi i energjisë elektrike do të bëhet me kushtet e përcaktuara në kontratat e shit-blerjes që do të nënshkruhen me shoqëritë fituese.

Ky njoftim publikohet në website zyrtar të KESH sh.a.